

KRONIKË E ZEZË

Një punëtor në Kamenicë plagoset nga grabitësi që po tentonte të vidhte



Foto: Ilustrim

Një punëtor në Kamenicë është plagosur me armë nga dikush që ka tentuar të vjedh në vendin ku viktima punonte.

Viktima ka thënë se pasi e ka vërejtur të dyshuarin dhe e ka pyetur se kush ishte, i dyshuari ka shtënë mbi të duke e plagosur.

Policia nuk ka arritur ta identifikojë ende të dyshuarin.

Punëtori i plagosur është në gjendje stabile dhe po trajtohet në spital.

“Viktima mashkull kosovar ka raportuar se ka vërejtur një të dyshuar deri me tani të pa njohur duke tentuar që të kryej vjedhje në një vend punishte ku viktima ishte duke punuar. Sapo viktima e ka pyetur se kush jeni ju, i dyshuari ka shtënë me armë zjarri në drejtim të viktimës me ç’rast e ka plagosur. I dyshuari ka ikur nga vendi i ngjarjes ndërsa viktima është duke u trajtuar në spitalin rajonal të Gjilanit dhe gjendja e tij është stabile. Njësitë relevante policore kanë dalë në vendin e ngjarjes, ku kanë gjetur dhe sekuestruar për procedura të mëtutjeshme hetimore një gëzhgojë. Në lidhje me rastin është konsultuar prokurori i shtetit, rasti në procedurë hetimore”, thuhet në raportin ditor të PK-së.

© KOHA. Të gjitha të drejtat janë të rezervuara.

Klikoni këtu nëse dëshironi t'i lexoni lajmet e fundit dhe të përzgjedhura në kanalin tonë zyrtar në Viber

#ARME #VRASJE NE TENTATIVE



If you own a mouse, you will never turn off your computer again.
No Install. Play for free.
Combat Siege | Sponsored [Play Now](#)



Albania Residents Might Get Online MBA Courses in USA
Best Online MBA Courses in USA | Search Ad | Sponsored



Zvicër, konfirmohet burgimi i përjetshëm i kosovarit që vrau bashkëshorten dhe kunatën
Një kosovar 60-vjeçar në Zvicër i është konfirmuar dënimi me burgim të përjetshëm, pasi ai kishte vrarë bashkëshorten dhe kunatën në Aargau, raporton “Blick”. Gjykata Federale ka ...
Kohananet



Luxury Apartment For Sale Dubai Cost Might Surprise You.
Dubai Apartments | Search Ads | Sponsored

TË TJERA

- 

10 të shoqëruar në Polici pas aksionit kundër përdoruesve të drogës në Prishtinë
- 

Dy vetura të postës së Serbisë ndalohen rrugës për në Leposaviq
- 

Policia kërkon ndihmën e qytetarëve për gjetjen e një personi të zhdukur
- 

Lirohet punëtori teknik i shkollës në Istog, që dyshohet se ngacmoi një nxënëse